



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 10, datë 16.01.2025

PËR
“CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E PROKURORIT NË
PROKURORINË E PËRGJITHSHME”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zoti Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 16.01.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 dhe vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa "a" të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;
2. Nenet 164, pika 8, 166, pikat 2 dhe 6, 189, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar;
3. Nenet 42 pika 2, 59 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
4. Rregullore "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" e ndryshuar.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues nr. 82, datë 14.01.2025, i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës;
- ii. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 06, datë 20.01.2020, ka vendosur komandimin e Znj. Pranvera Pustina (Hoxha), në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme. Periudha e komandimit ka filluar në datën 20.01.2020 dhe është përcaktuar për 5 (pesë) vjet.
3. Me shkresën nr. 2392 prot., datë 16.10.2024, Prokurori i Përgjithshëm i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë me kërkesë për ripërsëritjen e komandimit të prokurores Pranvera Pustina (Hoxha) në pozicionin e ndihmës magjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme, me një mandat 5 vjeçar, me arsyetimin se në disa drejtori e sektorë të Prokurorisë së Përgjithshme janë krijuar vakanca nga procesi i rivlerësimit kalimtar duke sjellë një situatë të rënduar.
- Në referim të nenit 53, pika 10, e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, përcaktohet se:

"Magjistratit të komanduar i bëhet vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për anëtarët e tjerë të këtij institucioni, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Nivelet e këtij vlerësimi njihen si nivele vlerësimi në kuptim të këtij ligji."

4. Me shkresën nr. 2392/1 Prot., datë 25.10.2024, Këshilli i Lartë i Prokurorisë i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm, dërgimin e vlerësimit etik dhe profesional për magjistratën



Pranvera Pustina (Hoxha), bazuar në nenet 53, pika 10 dhe 56, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

5. Nga ana e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, nuk është dërguar ende vlerësimi etik dhe profesional për magjistraten në fjalë.
6. Me qëllim trajtimin e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli vlerëson si të përshtatshëm, zbatimin e instrumentit të caktimit të përkohshëm për magjistraten Pustina (Hoxha), deri në dërgimin e vlerësimit etik dhe profesional nga ana e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
7. Në procedurën për caktimin e përkohshëm janë mbajtur parasysh parashikimet ligjore si më poshtë:
 - Neni 59 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikon se:

[...]1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

- a) caktimit në pozicione të tjera;
- b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji. [...]

- Në referim të nenit 42 pika 2, e ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se:

[...] ... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion." [...]

- Referuar nenit 3 të Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" e ndryshuar, përcaktohet se:

[...]Neni 3

Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve

1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm. [...]

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

8. Duke ruajtur frymën e ligjit, me qëllim garantimin e funksionalitetit të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe rëndësinë e përmbushjes së detyrave funksionale të këtij institucioni, si dhe duke patur parasysh se kushtet dhe rrethanat mbi bazën e të cilave është vendosur komandimi i mëparshëm i kësaj prokurore nuk kanë ndryshuar, Këshilli e vlerëson të përshtatshme për këtë pozicion, prokuroren Pranvera Pustina (Hoxha).
9. Bazuar në ligj dhe rregulloren e lartpërmendur, si dhe pasi bëri verifikimet përkatëse në zyrën e burimeve njerëzore, ku u konstatua se prokurorja Pustina nuk ka masë disiplinore në fuqi, propozon që zonja Pranvera Pustina (Hoxha), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila plotëson kriteret ligjore, të caktohet përkohësisht për një afat deri në tre muaj, duke nisur nga data 20.01.2025, në pozicionin e prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149 pika 1, 149/a pika 1 germa "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 42 pika 2 dhe nenin 59 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2 dhe 6, 189 pika 1, germa "a" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, në Rregulloren "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

V E N D O S I:

1. Zonja Pranvera Pustina (Hoxha), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Zonja Pranvera Pustina (Hoxha) do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, për një afat deri në tre muaj, duke nisur nga data 20.01.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Pranvera Pustina (Hoxha), Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erion Fejzulla